

KONTRATA SOCIALE VLORE

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE SHTATOR 2022-SHTATOR 2023

Viti i IV i monitorimit

**PËRGATITUR NGA:
QENDRA RINORE E VLORES**

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

TË KONTRATËS SOCIALE

BASHKIA VLORË

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Shtator 2022 – Shtator 2023

Përgatiti raportin: Qendra Rinore e Vlorës

FALENDERIME	4
RRJETI POP	5
SHKURTIME	6
HYRJE	7
METODOLOGJIA	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10
KONTRATA SOCIALE BASHKIA VLORE	11
KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ	12
VLERËSIMI I QYTETARËVE	14
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE	18
PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE	19
PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM	21
PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET	25
PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK	27
PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK	27
PRIORITET NR. 6: PASTRIMI	28
PRIORITET NR. 7: PASTRIMI	30
PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK	33
PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK	33
PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK	34
PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE	34
PRIORITET NR. 12: DEMOKRACIA VENDORE	35
REFERENCA	36
ANEKS	37

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë periudhës Shtator 2022 - Shtator 2023, dëshirojmë të falenderojmë në radhë të parë qytetarët dhe të rinjtë që ishin pjesë proaktive e këtij monitorimi, mediat lokale dhe sociale që veprojnë në qytet, bashkinë Vlorë me drejtoritë e institucionet e varësisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Një falenderim shkon dhe për anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët kanë kontribuar për monitorimin dhe përgatitjen e raporteve të ngjashme të monitorimit në bashki të tjera ku rrjet punon.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjetit POP.

Rrjeti POP

Rrjeti Përballja e Ofertave Politike (**Rrjeti POP**) është një nismë e 12 organizatave lokale të shoqërisë civile, të pavarura, të cilat synojnë të rrisin debatin publik dhe informacionin te qytetarët gjatë periudhave zgjedhore, si dhe orientimin e platformave politike drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve.

Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të programit të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan

Ky raport është përgatitur nga Qendra Rinore e Vlorës në kuadër të projektit dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy.

Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e Qendrës Rinore Vlorë.

Shkurtime

POP	Përballja e Ofertave Politike
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
Nj.A	Njësi Adminsitrative
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
U.K Vlorë	Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a.
OPIC	Qendra Ndërkombëtare Olof Palme
NED	National Endowment for Democracy
VYC	Qendra Rinore e Vlorës
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
KB	Këshilli Bashkiak
VKB	Vendime të Këshillit Bashkiak
SH.A.U.K	Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Vlorë
AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
MIM Vlorë	Ndërmarrja Bashkiake për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve Urbane
PVMIM	Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NSHP	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
GJKKO	Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. **Gjatë vitit 2019** janë hartuar kontratat sociale për **9 bashki** (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin **2021**, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës **shtator 2022-2023 për të katërtin vit me rradhë**, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga **Olof Plame International Centre (OPIC)** dhe **National Endowment for Democracy (NED)**.

Kontrata Sociale në Vlorë¹ përmban **12 prioritete** që qytetarët e Vlorës identifikuan në zgjedhjet lokale të 2019. Qendra Rinore e Vlorës (VYC) si anëtare e rrjetit POP, synoi të krijojë dhe mbështesë mekanizma qytetare, në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, si dhe në zgjedhjet vendore të majit 2023, ku me Bashkinë dhe anëtarët e Këshillit Bashkiak, nisën dialogun për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Qendra Rinore e Vlorës mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Vlorë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet vendore të majit 2023, advokoi me të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale. **Raporti i parë i monitorimit**² vlerësoi se rreth **47%** e prioriteteve të **Kontratës Sociale** u realizuan nga Bashkia Vlorë, ndërsa në **raportin e vitit të dytë të monitorimit**³ Bashkia përmbushi **65%** të kërkesave dhe prioriteteve të qytetarëve. Në vitin e tretë⁴ të monitorimit prioritetet qytetare u realizuan në masën **73.75%** ndërsa në vitin e fundit të monitorimit prioritetet u realizuan në masën **76,41%**

¹ Kontrata Sociale me bashkinë Vlorë: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

² Raporti I vitit të parë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-POP_Bashkia-Vlore.pdf

³ Raporti I vitit të dytë monitorues: https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/01/Raporti_POP_Bashkia-Vlore.pdf

⁴ Raporti i vitit të tretë monitorues: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2022/12/Raporti-POP-Bashkia-Vlore-2022.pdf>

Prioritetet e Kontratës Sociale ofrojnë një mundësi shumë të mirë që bashkia të kuptojë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të monitorimit në programet vendore përmes advokimit si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, duke përdorur procesin e **Buxhetimit me Pjesëmarrje** janë një tregues pozitiv i rritjes së **transparencës** dhe **llogaridhënies**.

Për monitorimin e prioriteteve të Kontratës Sociale janë konsultuar gjërësisht qytetarët, grupet e interesit, përfaqësues të mediave lokale, staf nga bashkia dhe anëtarë të këshillit bashkiak ku disa nga format e ndërveprimit dhe angazhimit ishin: takime ballë për ballë, intervista, kërkesa për informacion, monitorim i vendimarrjes së Këshillit Bashkiak, monitorim i daljeve publike në mediat sociale dhe lokale si dhe peticionet qytetare.

Gjetjet dhe rekomandimet e dala nga raportet monitoruese janë bërë pjesë integrale e komunikimeve me të gjithë grupet e interesit, ndërsa Qendra Rinore e Vlorës si anëtare e rrjetit POP, ka ndërmarrë fushata advokimi duke për prioritetet konkrete të Kontratës Sociale përmes procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje.

Për të mbërritur në vitin e katërt të monitorimit, Qendra Rinore e Vlorës pjesë e rrjetit POP arriti:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të realizojë takime dhe fokus-grupe me komunitetin për të matur progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të përgatisë raportin e katërt të monitorimit dhe gjetjet e rekomandimet të prezantohen në nivel kombëtar dhe atë lokal;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet përmes medimeve lokale mediatike;
- Të llojojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies;
- Të përdorë përgatisë dhe shpërndajë shkrime nga të rinjtë, përmes verifikimit të fakteve, për prioritetet e Kontratës Sociale;
- Të angazhojë qytetarët të adresojnë për zgjidhje prioritetet e Kontratës Sociale në dëgjesat publike të Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe të advokojë në nivel lokal dhe qëndror së bashku me aktorë të tjerë realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.

Raporti më poshtë vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën Shtator 2022 – Shtator 2023.

Metodologjia

Për të realizuar raportin Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të POP u bazua në hapat si më poshtë:

- U monitorua puna e Bashkisë Vlorë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën shtator 2022 – shtator 2023;
- U përgatit dhe u dërgua një kërkesë për informim mbi progresin e realizimit e prioriteteve.
- Monitorim i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak;
- U organizuan takime me staf të Bashkisë Vlorë mbi progresin e prioriteteve qytetare;
- U realizuan takime me anëtarë të komunitetit në Nj.A të Vlorës, që vlerësuan progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Angazhim i qytetarëve dhe stafit të bashkisë për realizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje për të advokuar që prioritetet të përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës;
- Monitorimi i realizimit të buxhetit vjetor dhe prioriteteve të Kontratës Sociale përmes të dhënave të hapura dhe prokurimeve publike;
- Konsultimi i dokumentave dhe strategjive të Bashkisë Vlorë, buxheti afatmesëm dhe ai vjetor, faqja e internetit e Bashkisë, etj;
- Analizim i monitorimit të mediave audio vizive dhe online sipas fushave specifike.

Përmbledhje Ekzekutive

Kontrata Sociale përben një dokument themelor ku qytetarët dhe bashkia e Vlorës për periudhën 2019-2023⁵, kanë rënë dakord të punojnë së bashku në funksion të zgjidhjes së shqetësimeve dhe problemeve që kanë nevojë për ndërhyrje përgjatë mandatit katërvjeçar. E firmosur prej 2019, raporti prezanton progresin e realizimit të prioriteve të qytetarëve. Raportimi i monitorimit të Kontratës Sociale përshkruan zhvillimin infrastrukturor, ekonomik, social dhe shoqëror të bashkisë së Vlorës, ku nga ana e bashkisë prezantohen arritjet ose jepen shpjegime për mos realizimin e disa prej prioritetëve, ndërsa në krahun tjetër atë të qytetarëve dhe shoqërisë civile ekziston një qasje kritike duke reflektuar pikat e dobëta, punët publike të porealizuara dhe shërbimet e munguara.

Ne jemi të vetëdijshëm që realizimi i prioritetëve të Kontratës Sociale kërkon shumë investime në burime njerëzore por edhe më shumë në burime financiare dhe Bashkia Vlorë me buxhetin që administron, mundësitë e ka të limituara. Edhe pse Bashkia e Vlorës përballlet me shumë sfida për të adresuar zgjidhje të komuniteti i saj, është e rëndësishme të theksojmë se **adresimi i nevojave, diskutimi e monitorimi** i tyre nga qytetarët dhe stafi i saj, është një element i shtuar i bashkëpunimit midis qytetarëve dhe qeverisjes vendore, në funksion të ngritjes së urave të komunikimit, duke kuptuar njëri-tjetrin për të përmirësuar ndërveprimin midis palëve, duke forcuar në këtë mënyrë edhe demokracinë lokale.

Raporti i Monitorimit të Kontratës Sociale, për periudhën shtator 2022 – shtator 2023, bazohet mbi progresin e çdo prioriteti qytetar që bashkia e Vlorës realizon në punën e saj të përditshme përmes vendimarrjes së Këshillit Bashkiak.

Të 12 prioritetet janë adresuar pjesërisht përmes hartimit të projekteve, planifikimit në buxhetin vendor, projekteve qeveritare dhe ndërmarrjes së nismave e politikave për përmirësimin e tyre. Nga 12 prioritetet e Kontratës Sociale vlerësojmë se nga **47.17%** e tyre që janë realizuar në raportin e parë të monitorimit për periudhën 2019-2020, në **65,25% për** raportin e dytë të monitorimit për 2020-2021, ndërsa për raportin e tretë të monitorimit që përfshin periudhën shtator 2021-shtator 2022, vlerësohet progresi i kontratës sociale në masën **73.75%**. Në periudhën shtator 2022-shtator 2023, raporti i katërt i monitorimit vlerëson progresin e Kontratës Sociale në realizimin e prioritetëve në masën **76.41%**

Çdo prioritet i Kontratës Sociale përmban një listë të gjatë indikatorësh, ndërsa theksojmë se ka përpjekje nga Bashkia Vlorë, që pjesa më e madhe e prioritetëve të adresohen me investime të drejtëpërdrejta, ndërsa janë hartuar projektet për studimin e fizibilitetit për prioritetet që kanë

⁵ Kontrata Sociale me bashkinë Vlorë: <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

nevojë për tu mbështetur financiarisht. Shtojmë së në monitorimin përfundimtar të kësaj kontrate, për disa prioritete situata reale nuk është e njëjtë me të dhënat e ofruara nga ana e stafit të Bashkisë. Edhe me verifikimet e fakteve realizuar nga Qendra Rinore e Vlorës, vlerësojmë se disa prioritete si furnizimi me ujë të pijshëm, sistemi i kanalizimeve, vendepozitimi i mbetjeve urbane janë pjesë e punës së subjekteve ligjëzbatuese ose fondet për to keqpërdoren duke sjellë humbje të besimit midis qytetarëve që këto ndërhyrje të përfundonin në kohë dhe të bëheshin të prekshme për komunitetin. Fillimi nga pika 0 për cdo administratë të re bashkiake shton përpjekjet tona për të rifilluar çdo gjë nga e para dhe rrit shqetësimin që prioritetet të marrin zgjidhje duke ulur ndjeshëm besimin dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimarrjen lokale.

Kontrata Sociale Bashkia Vlorë

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të garantuar që qytetarët marrin shërbime dhe mbështeten për mirëqenien e tyre. Por janë qytetarët, të rinjtë dhe aktorët e shoqërisë civile, që përmes mekanizmave të ndryshëm duhet t'i mbajnë ofruesit e shërbimeve përgjegjës në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe shërbimeve lokale.

Në Kontratën Sociale 2019 – 2023, qytetarët kanë dhënë opinionet e tyre për 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor: (i) Shërbimet publike; (ii) Zhvillimi ekonomik vendor; (iii) Dimensioni social dhe (iv) Demokracia vendore. Në bazë të këtyre prioriteteve, më datë 11.10.2019, mes Bashkisë Vlorë dhe Qendrës Rinore të Vlorës u firmos Kontrata Sociale. Prej momentit të nënshkrimit, Qendra Rinore e Vlorës, pjesë e rrjetit të organizatave që implementojnë në rang kombëtar projektin POP – Përballja e Ofertave Politike, është duke monitoruar përmbushjen e prioriteteve dhe pritshmëritë që komuniteti ka ndaj kësaj Kontrate Sociale.

Monitorimi i Kontratës Sociale është një proces sfidues dhe interaktiv që ofron mundësi që qytetarët dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile të rrisin nivelin e njohurive dhe të informacionit mbi mënyrat si funksionon qeverisja vendore, si merren vendimet e përmes saj kanë mundësi të analizojnë politikat vendore ndërsa përmirësohet dialogu dhe llogaridhënia midis të dyja palëve.

Qendra Rinore e Vlorës gjatë periudhës së monitorimit punoi për të adresuar kërkesat dhe ankesat, por edhe progresin e prioriteteve të Kontratës Sociale drejt Bashkisë Vlorë apo edhe KB, ndërsa media lokale vazhdon të mbështesë shqetësimet e banorëve përmes kronikave ose lajmeve në mediumet lokale, që prioritetet qytetare të adresohen për zgjidhje.

Në kuadër të zgjedhjeve vendore të majit 2023, Rrjeti POP krijoi një plaformë të hapur dhe të pavarur, ku rreth 1000 qytetarë nga zonat rurale dhe urbane (në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Elbasan dhe Korçë) artikuluan nevojat dhe prioritetet e tyre përmes 62 tryezave diskutimi. Prioritetet e qytetarëve të secilës bashki u pasqyruan në

10 (dhjetë) Kontrata Sociale⁶. Pas hartimit të Kontratave Sociale 2023-2027, të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre në 10 bashki të vendit, realizuan forumet publike me qytetarët. Forumet publike nxitën kulturën demokratike dhe synuan ofrimin e një hapësire të hapur dhe të barabartë për kandidatët e partive politike për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar me qytetarët mbi Kontratën Sociale dhe shqetësimet e tyre. Kontrata e re sociale në Vlorë për periudhën 2023-2027 nuk është pjesë e këtij raporti monitorimi, edhe pse disa prej prioriteteve vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e saj. Deri në periudhën e përgatitjes së këtij raporti, Kryetari i Bashkisë edhe pse mori angazhimin publik që do të punojë për prioritetet e Kontratës Sociale, ende nuk e ka firmosur.

Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak gjatë periudhës së monitorimit shtator 2022 – shtator 2023, ka realizuar në total **16 mbledhje**, ku janë marrë **105 vendime**. Këshilli Bashkiak i dalë nga zgjedhjet 2019-2023 numëronte **49 anëtarë (23M/26F)** nga të cilët **47 %** ishin djem dhe burra dhe **53%** ishin vajza dhe gra. Ndërsa Këshilli Bashkiak i dalë nga zgjedhjet vendore të majit 2023, numëron **51 anëtarë (27M/24F)**, përfaqësues të partive të ndryshme politike nga të cilët **53%** janë djem dhe burra dhe **47%** vajza dhe gra. (në të njëjtën përqindje si KB i kaluar)

Puna e Këshillit Bashkiak, pjesë e këtij raporti ndahet në dy periudha, vendimarrja për periudhën 2019-2023, që mbyllet me mbledhjen e fundit zhvilluar më datë 22 qershor 2023 dhe vendimarrja e anëtarëve të Këshillit të ri të dalë nga zgjedhjet vendore të majit 2023, për periudhën korrik – shtator 2023.

Këshilli Bashkiak i Vlorës ka fituar një rol të rëndësishëm në procesin e vendimarrjes për Bashkinë e Vlorës. Si një forum ku këshilltarët shqyrtojnë vendimet e Bashkisë në lidhje me interesat e qytetit, këshilli është bërë pjesë e një procesi sfidues gjatë periudhës së monitorimit nga shtatori 2022 - shtator 2023. Është vërejtur se kryefjala e diskutimeve në Këshillin Bashkiak ka qenë etika dhe mungesa e një komunikimi efektiv, si dhe një nivel i ulët i argumentimit për vendime të veçanta. Përveç kësaj, është evidentuar se ka pasur një mungesë të theksuar të informacioneve dhe në disa raste shpërfillje, nga disa drejtori të bashkisë për raportime mbi projekte të veçanta që zhvilloheshin në qytet, ndërsa raportet e buxhetit faktik, në shume raste janë raportuar nga këshilltarët si të dobët dhe jo-koerente me situatën reale. Këshilltarët drejtuan në mënyrë të vazhdueshme kërkesa për informacion, kërkuan takime me drejtori të Bashkisë Vlorë për të rritur llogaridhënien mbi shqetësime të ndryshme. Përplasje në komisionet e përhershme të këshillit, orare të zgjatura të transmetimit të drejtpërdrejtë dhe shkelje të etikës së komunikimit janë evidentuar gjatë periudhës së monitorimit. Nuk kanë munguar edhe bllokime të vendimeve që u paraqitën nga ana e stafit të bashkisë, duke evdientuar miratimin e Buxhetit për vitin 2023, që nuk arriti të miratohej në mbledhjet e dhjetorit 2022 duke u miratur

⁶ Faqe zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/kontratat-sociale-2023-2027/>

në limitet e afateve kohore, ne muajin janar 2023 (VKB nr.1, datë 18/01/2023), që sipas raportimit të bashkisë të buxhetit faktik ndikoi në kryerjen me vonesë të procedurave të prokurimit për realizimin e projekteve të planifikuara përgjatë periudhës së monitorimit

Një aspekt tjetër i monitoruar ka qënë dhe dokumentet e prodhuara nga ana e KB që rregullojnë funksionimin, transparencën dhe llogaridhënien e këtij organi të qeverisjes vendore ndaj qytetarëve, që efektet e tyre përfshijnë dhe prioritete të Kontratës Sociale. Në zbatim të Rregullores së Funksionimit dhe Organizimit të Këshillit Bashkiak, u miratua me VKB nr. 84 datë 30/11/2022, programi i punës së Këshillit Bashkiak Vlorëⁱ për periudhën janar – dhjetor 2023. Plani i punës ka në përbërjen e vet një plan aktivitetesh që bazohet mbi ligjin e qeverisjes vendore, rregulloret dhe strategjitë e miratuara, që lidhen me punën dhe mbështetjen financiare të Këshillit Bashkiak. Programi ka në përbërjen e vet një plan të konsultimit me publikun. Nga monitorimi i këtij plani dhe lidhja e tij me prioritetet e kontratës sociale, është realizuar në muajin prill 2023, një takim konsultues me të rinj dhe përfaqësues të Këshillit Vendor të Rinisë, ku u diskutuan sfidat dhe problematikat që kjo strukturë të bëhet funksionale.

Në lidhje me adminsitrimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Vlorë, dy vendime të rëndësishme janë marrë nga KB. Me vendim nr. 26 datë 31.03.2023ⁱⁱ është miratuar Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Bashkisë Vlorë 2023-2028ⁱⁱⁱ. Ky dokument i rëndësishëm parashikon ndërhyrjet në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane për periudhën në vazhdim, ndërsa edhe pas miratimit të tij, shumë pak informacione ka në territor mbi ndërhyrjet që parashikohen të adresohen përmes këtij plani. Gjithashtu në muajin mars me vendim nr. 27 datë 31.03.2023, Këshilli Bashkiak miratoi shtesë fondi për të përballuar ndryshimin e pagës minimale si dhe miratimin e transferimit të fondit financiar në buxhetin e vitit 2023, sipas analizës financiare për realizimin e shërbimit të pastrimit të qytetit të Vlorës dhe njërive adminsitrativë, përmes Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Përmes miratimit të dy vendimeve të rëndësishme pritet që të ndryshojë administrimi i mbetjeve urbane dhe menaxhimi i integruar i tyre në periudhë afatëgjatë.

Në mbledhjen e konsituimit të Këshilli Bashkiak të Vlorës zhvilluar me datë 3 korrik 2023, ka patur përplasje midis këshilltarëve përfaqësues të forcave të ndryshme politike, për zbatimin e *Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Bashkiak Vlorë* (miratuar me vendim nr. 37 datë 28 prill 2022), ku partitë opozitare kërkonin zbatimin e saj, ndërsa një pjesë e anëtarëve përfaqësues të Partisë Socialiste, që e kishin miratur vetë këtë dokument nuk ia dolën ta zbatojnë atë. Përplasjet kanë vazhduar edhe në mbledhjet e realizuara prej korrikut deri në shtator të 2023, ku kryefjala e diskutimeve ka qënë zbatimi i rregullores.

Vlerësojmë faktin se mbledhjet e KB gjatë periudhës së monitorimit, janë transmetuar online dhe publiku është informuar mbi vendimet e marra përmes ndarjes ne kohe reale në faqen e FB të Këshillit Bashkiak Vlorë dhe kronikave në mediat lokale. Prej korrikut deri më shtator 2023, është rritur cilësia e trasmetimit live të mbledhjeve duke rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut. Është vënë re një numër i shtuar i qytetarëve që ndjekin mbledhjet online.

Gjithësesi nga monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, vëmë re se këshilltarët kanë trajtuar gjerësisht tema që janë prioritete të Kontratës Sociale, sic është transporti publik, furnizimi me

ujë të pijshëm, infrastruktura rrugore, etj, por vetëm në pak raste janë ofruar zgjidhje nga ana bashkisë.

Monitorimi nxorri në pah që sigurimi i një angazhimi dhe konsultimi efektiv me publikun në nivel lokal vijon të mbetet një sfidë për anëtarët e Këshillit Bashkiak. Nga monitorimi u evidentua se përfshirja e qytetarëve në proceset e konsultimit me anëtarët e KB-së është në nivele të ulta dhe se duhet bërë më tepër në këtë drejtim. Edhe pse KB ka rregullore, plane pune dhe një buxhet të dedikuar vjetor, nevojitet të përmirësohet puna për informimin dhe konsultimin e vendimarrjes në kohë e në mënyrën e duhur dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në to, paralelisht me përpjekjet që rritin ndërgjegjësimin dhe aktivizimin qytetar në nivel vendor.

Vlerësimi i qytetarëve

Pjesëmarrja qytetare paraqet një pjesë të rëndësishme në përcaktimin e efikasitetit të prioritetëve të Kontratës Sociale. Opinione dhe mendimet e qytetarëve janë një burim kritik për analizën e situatës në terren. Në përmbushje të misionit të Rjetit POP, gjatë periudhës është punuar që zëri dhe roli i qytetarëve të fuqizohen përmes mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit rreth rezultateve të monitorimit si edhe artikullimit të shqetësimeve të tyre në prioritetet e reja të Kontratës Sociale 2023-2027, duke i ekspozuar hershëm kandidatët për kryetarë bashkie dhe partitë politike, me nevoja qytetare që duhen adresuar për zgjidhje, për ti përfshirë në agendat e tyre të punës

Projekti ka hyre në vitin e katërt të realizimit të tij dhe metodologjia përmes të cilës ai realizohet është interaktive, duke lejuar modifikime të nevojshme për të prekur rezultate konkrete. Ndërsa takimet me qytetarët vazhdojnë të realizohen dhe kërkesat e tyre të përkthyer në prioritetet që kërkojnë zgjidhje, vazhdojnë të artikulojnë.

Qendra Rinore e Vlorës ka kërkuar që të orientojë punën e saj drejt grupeve që kërkojnë që zëri i tyre të dëgjohet që vijnë kryesisht nga komunitete të vogla, të rinj dhe aktivistë që përfshihen në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve pjesë përbërëse të Kontratës Sociale.

Për të kapur perspektivën e tyre, janë organizuar takime, fokus-grupe dhe forume me kandidatët për kryetar bashkie ndërsa pjesë integrale kanë qënë dhe dëgjuesat publike të procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje.

Ndërsa Bashkia Vlorë dhe Këshilli Bashkiak vazhdojnë të miratojnë pafund dokumente, udhëzues dhe të prodhojnë polemika, gjatë monitorimit të realizuar është vënë re, që besimi dhe përfaqësimi i qytetarëve në vendimarrje është në nivelet më të ulta. Mjaft qytetarë shprehen të

zhgenjyer dhe nënvizojnë se prej vitesh shprehin të njëjtat shqetësime, ndërsa situata ndyshon shumë pak.

Gjithësesi duke qënë një vit zgjedhor qytetarët kanë sjellë shqetësimet kryesore mbi prioritetet e Kontratës Sociale 2019-2023 që mbeten ende për tu adresuar dhe për tu zgjidhur nga ana Bashkisë dhe KB Vlorë, gjithashtu kanë ngritur edhe çështje të reja ku duhet ndërhyrje konkrete nga vendimarrësit, për periudhën 2023-2027. Ndërkaq, konteksti politik në zgjedhjet vendore të 2023 nuk lejoi një dialog të hapur midis kandidatëve. por mbeti e hapur për forume me qytetarët. Fushata u karakterizua nga programe të kufizuara duke lënë shumë pak hapësirë për premtime konkrete.

Prezantimi i raportit të monitorimit, në muajin janar 2023, midis grupeve të interesit dhe anëtareve të Këshillit Bashkiak, mundësoi që 71 persona (42 F/29M), përfituesit e programit të kishin informacion më të zgjeruar rreth procesit, duke sjellë anagazhim të rritur në aktivitetet që pasuan Kontratën Sociale dhe forumin me kandidatët. Prezantimi i raportit të vitit të tretë të monitorimit, ishte një mundësi shumë e mirë që Qendra Rinore e Vlorës përdori për të rritur ndërgjegjësimin mbi ndërhyrjet konkrete që mund të ndihmonin qytetarët të gjenin zgjidhje për probematikat e tyre të ngritura prej kohësh, duke shfrytëzuar periudhën parazgjedhore si një mundësi të mirë për të advokuar në emër të grupeve qytetare të asistuar nga projekti.

Gjithashtu prej shkurtit deri në mars 2023, Qendra Rinore e Vlorës realizoi 6 fokus-grupe me pjesëmarrje të gjerë të 93 personave (67F/26M) përfaqësues nga qytetarë të NJ.A nga grupeve të mënjanuara dhe ekspertëve të shoqërisë civile, që dhanë kontributin e tyre në vlerësimin e prioritetëve të Kontratës Sociale, ndërsa dhanë dhe kontribut konkret në identifikimin e prioritetëve të reja të saj.

Në shtator janë realizuar fokus-grupe me 41 qytetarë dhe të rinj (28F/13M), për progresin e prioritetëve të Kontratës Sociale. Ne grupe më të vogla janë forcuar kapacitetet e të rinjve, për të advokuar për prioritetet e vecanta të Kontratës Sociale.

Gjithashtu në muajin tetor 2023, janë mobilizuar qytetarë për të marrë pjesë dhe për të diskutuar shqetësimet e tyre në dëgjesat publike të realizuara nga Bashkia Vlorë për procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje. Nga 9 dëgjesat publike, janë monitoruar 7 prej tyre, ku morën pjesë 276 persona (84f/192M) në Njësitë Administrative dhe rajonet e qytetit.

Shqetësimet e qytetarëve për furnizimin me ujë të pijshëm, janë transmetuar në dy konsultime publike që SH.A.U.K kanë realizuar në muajin shtator dhe dhjetor 2023.

Gjithashtu situata shqetësuese e djegies së mbeturinave në vendgrumbullimin ekzistues të Vlorës, ka bërë bashkë 23 organizata dhe përfaqësues të shoqërisë civile që nënshkruan një peticion dhe ia drejtuan bashkisë Vlorë në muajin nëntor 2023.

Gjithashtu vlerësojmë se Bashkia dhe Këshilli Bashkiak nuk kanë ende platforma apo mekanizma që raportojnë për përmbushjen e kërkesave të qytetarëve.

Më poshtë po listojmë gjetjet nga takimet me qytetarët për çdo prioritet të Kontratës Sociale.

Prioriteti 1: - Investimet e realizuara që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e banimit, të indentifikuara nga qytetarët për ndërhyrje janë përmirësuar me investime konkrete kryesisht në periudhën parazgjedhore. Gjithësesi qytetarët shprehen të shqetësuar për vazhdimësinë e këtyre investimeve, pas mbarimit të zgjedhjeve. Ata kërkojnë që Bashkia Vlorë të punojë me përkushtim dhe të ndërhyjë sa më shpejt në infrastrukturën rrugore. Në takimet e realizuara, qytetarët shprehen se ka ende shumë punë për tu bërë, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, shtrimin e trotuarëve dhe përmirësimin e ndriçimit. Ata vazhdojnë të rendisin rrugët që kanë nevojë për ndërhyrje, ndërsa shtojnë se Bashkia nuk ia doli dot në kaq vite të punonte me sistem dhe të reduktonte numrin e rrugëve që kishin nevojë për ndërhyrje.

Në Njësitë Administrative shumë rrugë mbeten për tu rregulluar, gjithsesi qytetarët kanë identifikuar dhe vlerësuar pozitivisht ato pak ndërhyrje që bashkia realizoi në periudhën zgjedhore. Ata janë të vetëdijshëm se duhet të shfrytëzojnë periudhat zgjedhore për të advokuar për prioritete jetësore, ndërsa nënvizojnë se pas zgjedhjeve shumë pak kanë mundësi të gjejnë zgjidhje.

Prioriteti 2: - Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm në qytet dhe zgjatja e orarit të furnizimit me ujë në të gjithë qytetin.

Prej vitesh qytetarët janë në djeni që ka projekte madhore që do të duhet të ndryshonin situatën e furnizimit me ujë të pijshëm në qytet. Por deri në periudhën e raportimit ende nuk ka ndryshime për ta. Situata është problematike gjatë periudhës së verës, në një qytet turistik, ndërsa defektet kanë qënë të shumtë. Qytetarët e pyetur vlerësojnë negativisht performancën e SH.A.U.K dhe Bashkisë Vlorë, lidhur me këtë shërbim dhe në mjaft raste ata flasin dhe për abuzime. Ata janë në pritje që prej 2019 që të marrin shërbim më cilësor dhe të zgjaten oraret e furnizimit me ujë, por situata ende nuk ka ndryshuar. Me ndryshimin kompetencave dhe krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime që në përbërje të saj ka tre bashkitë e Vlorës, Selenicës dhe Himarës ata shprehen se do të dojë shumë kohë që të ndryshojë situata.

Përsa i përket Njësiave Administrative situata vazhdon të mbetet e njëjtë. Gjatë verës banorë të **Orikumit** kërkuan të protestonin pranë Bashkisë Vlorë, për situatën e furnizimit me ujë. Pjesa më e madhe e banorëve kanë hapur puse ose kanë instaluar bolierë ndërsa uji vjen me kufizime, vetëm dy herë në ditë. Situatë akoma me problematike raportohet edhe në Nj. A **Novoselë**, ku projekti i furnizimit me ujë të 15 fshatrave nuk duket se ka për të mbaruar ndonjëherë. Qytetarët shprehen se ka patur investime por ato janë bërë keq duke lënë jashtë projektit disa fshatra dhe ende nuk janë bërë lidhjet e brendshme. Edhe Nj. A **Qendër** e **Shushicë** e njëjta situatë. Si çdo vit

banorët protestuan para bashkisë për mungesën e ujit⁷. Investime që janë ende në proces prej 4 vjetësh, por që nuk mundësojnë aksesin e qytetarëve në furnizimin me ujë të pijshëm.

Prioriteti 3: - Përmirësimi i cilësisë së kanalizimeve, vazhdon të mbetet një sfidë për **Nj.A** ku pothuajse nuk ekziston rrjeti i kanalizimeve, ndërsa në **Vlorë** në disa zona të veçanta të saj, është përmirësuar sistemi i kanalizimeve të ujrave të ndotura. Gjithsesi banorët kërkojnë investime në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike të qytetit si dhe pastrimin e kanaleve në disa lagje të qytetit dhe kanalizimeve për të parandaluar përmytjet në kohën e reshjeve. Në **Novoselë:** Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, sidomos në fshatrat Mifol dhe Akërni, si dhe kanalizimet e ujërave të zeza në Panaja. Gjithësesi gjithë Nj.A-të nuk kanë rrjet të kanalizimit të ujrave të zeza. Në **Orikum:** Mungojnë kanalizimet në qytet, ndërsa vazhdon të mbetet problem kullimi i pjesës së kënetës që është bërë vatër infeksioni duke krijuar shqetësim për banorët e zonës dhe turistët gjatë verës. Ujrat e zeza vazhdojnë të derdhen në det. Në Nj.A **Qendër Vlorë:** Rikonstruksioni i rrjetit të ujërave të ndotura në fshatrat e kësaj njësie. Ndërsa në **Nj.A Shushicë:** Mungon rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Prioriteti 5:- Në lidhje me **transportin publik**, asnjë ndryshim nuk u raportua nga qytetarët. Nevojitet që ky shërbim të bëhet funksional sidomos në periudhën e verës. Qytetarët shprehen se kanë gjetur vetë zgjidhjet ndërsa besojnë se bashkia Vlorë nuk ka në prioritetet e saj këtë shërbim.

Prioriteti 6:- Qytetarët shprehen shumë të shqetësuar në lidhje me këtë prioritet. Prej fundit të qershorit⁸ 2023⁹ e në vazhdim, situatata është shqetësuese ku vazhdojnë të ketë zjarre të vazhdueshme në vendgrumbullimin ekzistues të mbetjeve urbane. Djegia e mbeturinave ka vazhduar edhe më vonë duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e banorëve. Në lidhje me vendepozitim të Sherishtës, vazhdon ende të jetë i bllokuar nga SPAK dhe aktualisht administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK).

Ndërkohë për prioritetin 7, atë të përmirësimit të **pastrimit të qytetit** dhe **Nj.A**, qytetarët kanë vlerësuar përpjekjet e Bashkisë për të ofruar shërbim cilësor në periudhën e verës. Shtimi i koshave dhe mjeteve është evidentuar nga qytetarët, por ata referojnë se pushesit që frekuentojnë Vlorën kanë nevojë të marrin shërbim më të mirë. Gjithësesi nevojitet ende punë për tu bërë nga ana e Bashkisë. Gjatë verës mediat lokale kanë raportuar vazhdimisht problemet me pastrimin e qytetit dhe Nj.A.

Prioriteti 8:- Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve është vlerësuar shërbimi informues dhe këshillues që stafi i bashkisë ka ofruar.

⁷ Banoret e Nartes ne proteste per mungesen e ujit: <https://www.youtube.com/watch?v=kLqAGNEGvgg>

⁸ <https://www.tpz.al/aktualitet/tymi-pushton-vloren-zjarr-i-qellimshem-ne-piken-e-grumbullimit-te-mbe-i219397>

⁹ <https://abcnews.al/zjarr-i-madh-ne-vlore-helikopteri-nderhyn-per-te-shuar-flaket-2/>

Prioriteti 9: Qytetarët shprehen bashkia e Vlorës i informon dhe mbledh taksat rregullisht, ndërsa kërkojnë më tepër shërbime për taksat që paguajnë, kryesisht në sportelet e ujësjellësit apo drejtorive të tjera të këtij institucioni.

Prioriteti 10:- Zhvillimi i sektorit turistik në verën e 2023, solli një kërkësë të rritur të subjekteve turistike për punonjës të kualifikuar ose jo, kryesisht të rinj ose gra. Emigrimi masiv dhe kërkesa e sektorit turistik, duhet të orientojë bashkinë e Vlorës drejt politikave të qarta për këtë sektor. Gjithësesi qytetarët shprehen se operatorët ekonomikë janë ata që ofrojnë mundësi dhe bëjnë politikat reale në qytetet. Edhe bashkia e Vlorës ndihmoi që të ulej papunësinë ku ajo bëri thirrje të vazhdueshme për shtimin e punonjësve të pakualifikuar për NSHP, prej momentit kur kjo drejtori administroi shërbimin e pastrimit.

Prioriteti 11:- qytetarët shprehen se kanë marrë pjesë, dëgjuar ose njohur nga mediat që procesi i buxhetimit me pjesëmarrje realizohet, por vazhdojnë të mbeten skeptikë nëse kërkesat që ata diskutojnë në këto takime mund të merren parasysh nga ana e Bashkisë.

Prioriteti 12:- Këshilli Vendor i Rinisë është një strukturë që duhet degjuar dhe mbështetur. Të rinjtë shprehen se shumë pak kanë dëgjuar për të dhe kërkojnë që kjo strukturë të bëhet aktive.

Analiza e gjetjeve për secilin prioritet sipas Kontratës Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që Qendra Rinore e Vlorës i ka dërguar bashkisë Vlorë, takimeve me staf të bashkisë, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave si dhe në informacionet e mbledhura nga të dhënat e hapura (shpenzime dhe prokurime) të qeverisjes vendore si dhe nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Vlorë. Gjithashtu janë analizuar dhe vendimet e miratuara nga Këshilli Bashkiak i Vlorës për periudhën shtator 2022 – shtator 2023.

Progresi i monitorimit të realizimit të prioritetëve raportohet në disa faza që janë:

Prioritet i pa realizuar

Prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i buxhetuar ose prioritet i prokuruar)

Prioritet i realizuar

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se bashkia Vlorë ka adresuar prioritet si më poshtë:

PRIORITET NR. 1: INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

- Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit.

Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosije e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Gjetjet nga raporti i katërt i monitorimit treguan se nga 10 indikatorë janë përfunduar me investime konkrete 9 të tillë, që vlerësonte progresin në masën 90%, të treguara në tabelën mëposhtë:

Prioritete të realizuara	Prioritete të parealizuara
Zona tek Fusha e Drurit	Rruga “Jani Kosta/Rexha”
Rruga tek Tregu i Madh	
Rruga pas KSHA-së	
Rruga nga fabrika e tullave	
Porti drejt plazhit të vjeter	
Rruga dhe lagjia pas Stadiumit (Mato Robi)	
Lagjia pas kopshtit Nr 10	
Rruga tek fusha e aviacionit, kanë filluar punimet me mbështetjen e FSHZH-së	
Vendosije e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon. (i realizuar pjesërisht)	

Në lidhje me vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku mungon, nga bashkia konfirmohet se sektori i shërbimeve dhe rrugë-trotuareve ka ndërhyrë pjesërisht në vendet ku janë dëmtuar trotuaret dhe kanë vendosur sinjalistikën vertikale përmes tabelave. Gjatë vitit 2023 nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i mirëmbajtjes së rrugëve, trotuareve janë bërë vizimet e këmbësorëve përgjatë rrugëve kryesore. Prioritet i adresuar pjesërisht.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është nga 50% në vitin e parë të monitorimit në 70%+ në vitin e dytë të monitorimit, në 80 % për vitin e tretë të monitorimit në 90% periudha shtator 2022-shtator2023 (nga 10 indikatorë janë përfunduar 9). Prioritet i realizuar.

Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skrofotinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Ky është një prioritet i realizuar në masën 100%. Gjithashtu shtojmë se me fonde të FSHZH-së, rruga e vjetër që lidh Vlorën me Fierin i është nënshtruar rikualifikimit duke rritur aksesin e fshatrave të Nj.A Novoselë drejt qytetit. Rregullimi i këtij segmenti rriti mobilitetin dhe zhvillimin ekonomik të zonës, sidomos gjatë periudhës së verës. Pas riasfaltimit të rrugëve lidhëse midis fshatrave kryesore, kërkohet nga qytetarët që të vazhdojnë investimet edhe në fshatrat e tjerë të Nj.A Novoselë.

Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Radhimës dhe të Thilpetit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Nga lista e indikatorëve për ndërhyrje në Nj.A Orikum, sistemimi i rrugës së Kishës së Marmiroit edhe pse është listuar në projekte që kanë nevojë të financohen në buxhetin e vitit 2023, vazhdon të mbetet në listën e projekteve që kërkojnë financim me mbështetje nga FSHZH.

Rruga buzë detit është bërë pjesërisht, gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2021, vetëm njëra anë ndërsa duhet përfunduar edhe segmenti tjetër deri tek postblloku i vjetër. Ndërsa rruga lidhëse e Tragjasit është përfunduar, por nevojitet edhe zgjerimi i rrugës së Radhimës. Pastrimi i i kanaleve në Tragjas, Dukat dhe Radhimë është një proces që realizohet, por qytetarët nuk raportojnë ndonjë ndryshim të situatës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 30%, në të njëjtën masë raportimi si viti i kaluar dhe është prioritet i përfunduar.

Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rrugët lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Është realizuar rikonstruksioni i rrugës Panaja – Hoshtimë. Punimet janë realizuar nga Avduli shpk dhe gjatë vitit 2022 janë kryer dhe pagesat nga bashkia Vlorë. Aktualisht është rrezultat i përfunduar.

Rruga Babicë e Vogël - Xhyherinë është realizuar gjatë 2021 dhe likujduar në të njëjtin vit nga stafi i bashkisë.

Rruga e Sherishtës e përfshirë në projektin “Rikualifikim urban në Njësinë Administrative Qendër (Nartë + Sherishtë)”, ka përfunduar.

Rruga lidhëse midis Kërkovës dhe Bestrovës. Rruga lidhëse midis Kërkovës dhe Bestrovës është përfunduar, ndërsa kërkohet që të përfundojë edhe rruga e Bestrovës. Aktualisht raportojmë se ky prioritet është plotësuar në masën 90%.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres ai është në masën 90%. Nga 70% në vitin e dytë të monitorimit në 90% në vitin e tretë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar plotësisht (Prioritete të buxhetuar, të prokuruar dhe të realizuar).

Shushicë. Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Nga raporti i dytë i monitorimit është përfunduar rikonstruksion i rrugës lidhëse Shushicë-Beshisht. Gjithashtu edhe rruga e varrezave në fshatin Drithas është rikonstruktuar.

Bashkia Vlorë ka përgatitur dhe dokumentacionin përkatës gjatë 2022, për të tenderuar edhe rrugët e mëposhtme: Rehabilitimi i rrugës së fshatit Drithas dhe rehabilitim i rrugës së fshatit Grabian në Nj.A Shushicë ka përfunduar.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90% dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritet i prokuruar dhe i realizuar)

PRIORITET NR. 2: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

- **Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë:**

Për rajonet e qytetit Vlorë. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Nga informacionet e grumbulluara prej 2019, në Bashkinë e Vlorës me bashkëfinancim të Qeverisë Shqiptare janë duke realizuar disa projekte madhore në çështjen e rëndësishme, atë të përmirësimit të furnizimit me ujë. Më poshtë listojmë ndërhyrjet në këtë sektor të cilat vazhdojnë prej 2020 e deri më sot, ndërsa parashikohej që përfundimi i tyre të jetë në 2023-2024:

- Përmirësime të sistemit me ujë në lagjet ish-fabrika e Çimentos-Partizani-Karabash dhe rindërtimi i ujësjellësit në Babicë të Vogël, Nj.A Qendër Vlorë, vazhdim nga 2021;
- Ndërtim KUZ, rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë, vazhdim nga 2021;
- Përmirësimi i infrastruktures se ujërave te zeza ne zonën bregdetare Vlorë, në vazhdim nga 2021;
- Ujësjellësi -Zona e Ujit të Ftohtë dhe Lungomares Rrapi Uji i Ftohtë - Shkolla e Marinës, vazhdim;
- Ndërtimi i ujësjellësit ne rrugen transballkanike Vlorë, Bashkia Vlorë, vazhdim nga 2021
- Rikonstruksion i ujësjellësit në 15 fshatrat e njësisë Administrative Novoselë, 50m, vazhdim nga 2021;

Aktualisht edhe në vitin e katërt të monitorimit, furnizimi me ujë të pijshëm bëhet dy herë në ditë, në gjithë qytetin e Vlorës, me përjashtim të zonës së Ujit të Ftohtë, që furnizohet me ujë 24 orë në ditë. Ndërsa gjithë Nj.A-të vazhdojnë të furnizohen me ujë në orare të caktuara, ndërsa shumë prej tyre vuajnë mungesa e cilësisë së ujit. Edhe pse projektet në sektorin e ujësjellësit janë ende në fazën e zbatimit, komuniteti ka paraqitur shqetësimet për mënyrën si po realizohen kryesisht duke raportuar a) për dëmtimet në infrastrukturën rrugore, b) kërkesa për ndryshim të projekteve fillestare që kanë ardhur nga Nj.A-të. Mbetet për tu verifikuar nëse cilësia e punimeve do jetë në funksion të realizimit të qëllimit final, atë të aksesit dhe furnizimit me ujë të banorëve të Bashkisë Vlorë. Të gjitha këto projekte synojnë ndërhyrje afatëgjata që do të përmirësojnë ndjeshëm situatën.

Gjithësesi, gjatë monitorimit është vënë re se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim i situatës.

Sh.A UK Vlorë në periudhën e monitorimit ka disbursuar fonde për projektin e “Përmirësimit me ujë Lagja Ish Fabrika e Çimentos Partizani Karabash si dhe Ujësjiellësi Babicë e Vogël” në shumën prej 52,969,766 lekësh të rinj, për periudhën tetor 2022-qershor 2023 (AGBES KONSTRUKSION). Investimet ende nuk kanë përfunduar ndërsa banorët gjatë gjithë periudhës së verës janë ndeshur me një situatë të rënduar me trafik të limituar në zonën e investimit. *Ujë nuk ka akoma.*

Me marrjen e mandatit të kryetarit të Bashkisë, situata reale e projekteve madhore dhe humbjeve të Ujësjiellës Kanalizime Sh.A do të bëhet e njohur për publikun dhe komunitetin.

Më datë 31.07.2023, me vendim nr. 61, Këshilli Bashkiak i Vlorës miratoi “Marrëveshjen për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve ndërmjet Bashkisë Vlorë, Bashkisë Himarë, Bashkisë Selenicë dhe Ministrisë së Infrastukturës dhe Energjisë”. Marrëveshja kishte ndër të tjera si qëllim krijimin e subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjiellës-Kanalizimeve (SKP-UK) që do të kryejnë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin e Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë, në bashkëpunim dhe me AKUM-in në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë. Me anë të kësaj marrëveshje u krijua SH.A “Shoqëria Rajonale e Ujësjiellës Kanalizime Vlorë”, më datë 20/09/2023, ku MIE ka 51% të aksioneve të kapitalit fillestar, Bashkia Vlorë zotëron 41.35% të aksioneve, Bashkia Himarë 4.60% të kapitalit fillestar dhe Bashkia Selenicë ka 3,05% të aksioneve.

Sipas Reporter¹⁰ në një shkrim të botuar në muajin gusht 2023, Ujësjiellësi i Vlorës mbylli vitin 2022 me 340 milionë lekë (3.4 milionë euro) humbje. Në vitin 2021, kompania pati humbur 244 milionë lekë. Humbjet vit pas viti të akumuluar kanë bërë që kompania të ketë 8.3 miliardë lekë asete dhe 8 miliardë lekë detyrime, me një levë financiare (kapital aksioner në raport me asetet) prej vetëm 3%. Sipas të dhënave të Entit Rregullator të Energjisë, në Vlorë humbet 76% e ujit të furnizuar në rrjet, ndërsa kompania ka gati 4 punëtorë për çdo një mijë lidhje në rrjet.

Më datë 15 shtator u bëmë pjesë e dëgjësës publike nga Ujësjiellës Kanalizime Vlorë, për ndryshimin e nivelit të tarifave të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Dëgjesa e moderuar nga stafi i UK Vlorë, mblodhi përfaqësues të Këshillit Bashkiak, qytetarë e banorë të qytetit dhe njësie administrative përreth, përfaqësues nga Enti Rregullator i Ujit dhe KFË. Në pjesën e parë të

¹⁰ <https://www.reporter.al/2023/08/04/ujesjiellesit-ne-prag-falimenti-ne-mase/>

dëgjesës u prezantua një përmbledhje të gjendjes ku ndodhet shoqëria, ku borxhi i saj ndaj palëve të tjera përlogaritet rreth 1.3 milion euro, ndërsa u theksua se rreth 92% e territorit mbulohet me furnizimin me ujë të pijshëm dhe në rreth 66% të teritorit ndodh largimi i ujrave të ndotura. U theksua se shumë nga asetet e shoqërisë janë të konsumuara dhe jetëgjatësia e tyre është më shumë se 30 vjet. Ndërsa ndërrmarja faturon me çmim më të ulët se kostua e shërbimit që marrin qytetarët. Ndaj shtrohet nevoja për ndryshim të nivelit tarifor, ku tarifatat e reja të propozuara për furnizimin me ujë të pijshëm mendohet të shkojnë nga 45 lek në 60 lek/m² për qytetarët dhe nga 100 lek në 133 lek/m² për bizneset.

Në takim qytetarët kërkuan rritje të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë (zona që furnizohen 2 orë ne ditë, ndërsa ka fshatra që furnizohen 1 herë në dy ditë me ujë) dhe cilësisë së shërbimit duke kërkuar administrim më të mirë të shoqërisë përmes uljeve të shpenzimeve të tepërta. Gjithashtu ata theksuan dhe ndalimin e derdhjes në det të ujarve të zeza. U kërkua që projektet e investimeve në ujësjellës që financohen nga qeveria qendrore, të përfundojnë dhe të mos ketë më vonesa. Mjaft nga shqetësimet e banorëve, sidomos nga njësitë administrative u përcollën në takim si pjesë e punës monitoruese të Kontratës Sociale.

Duke u nisur nga të dhënat e marra në këtë dëgjesë publike, anëtarë të Këshillit Bashkiak kërkuan një informacion të detajuar mbi situatën e kësaj ndërmarrjeje. Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak në muajin shtator, gjatë prezantimit të buxhetit faktik janar-gusht 2023, këshilltarë të opozitës ngritën shqetësimin se Ujësllesi nuk ka kryer në llogari të bashkisë derdhjen e 1.3 milionë eurove taksa, të mbledhura me faturat e ujit. Anëtarët e Këshillit referuan se për këtë dëm financiar nuk kanë qenë në dijeni, ndërsa thanë se ujësjellësi ka shpërdoruar në mënyrë të paligjshme për nevojat e tij 1.3 milionë euro taksa të qytetarëve. Kjo ka shpënë në një reduktim të planit të mbledhjes së taksave dhe tarifave vendore e përkthyer në investime të munguara për qytetarët e Vlorës.

Deri në shtator të 2023, ky prioritet nuk është adresuar për zgjidhje. Midis borxheve të fshehura dhe detyrimeve të palët e treta, shkrirja e shoqërisë dhe mospërfundimi i investimeve të filluara prej 2020, vlerësohet se nuk ka ndryshim të progresit për këtë prioritet.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres. Ai vlerësohet 80%+ për vitin e katërt të monitorimit në të njëjtën masë si viti i tretë i monitorimit, nga 70%+ në vitin e dytë, dhe është prioritet i adresuar pjesërisht (Prioritete të prokuruar dhe duke u realizuar).

Novoselë. *Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin veçanërisht gjatë verës.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Mbetjeve (AKUM), me fondet e buxhetit të shtetit dhe Bashkia Vlorë janë duke vazhduar investimin në projektin e rikonstruksionit të ujësjellësit të 15 fshatrave të Nj.A Novoselë. Në projektin e ri punimet përfshijnë zëvendësimin e pompave ekzistuese për 7 puset më të reja dhe të tubove të vjetra të dërgimit në rezervuarin grumbullues qendror; zëvendësimin e linjave të ujësjellësit për 15 fshatrat; përmirësimin e rrjetit

shpërndarës për lagjet e reja dhe do të instalohen rreth 4,180 matës të ujit për të gjithë fshatrat e zonës të Novoselës.

Gjithësesi gjatë komunikimeve të anëtarëve të KB me përfaqësues nga Nj.A Novoselë projekti që aktualisht po zbatohet ka nevojë për rishikime dhe ndryshime të reja. Kërkohej të planifikohet ndryshimi i projektit të furnizimit me ujë të pijshëm të 15 fshatrave në Nj.a Novoselë duke kërkuar përfshirjen e rrjetit të brendshëm nga Alibani deri në Akëri dhe në Kërkovë. Projekti për një periudhë kohe është pezulluar, ndërsa firmat zbatuese B.O.E, "GENER 2" & "Rroku GUEST" shpk mbeten në pritje të pagesave për të vazhduar realizimin e kontratës. Ndërsa përfundimi i punimeve është parashikuar 2024. Gjatë periudhës së monitorimit asnjë pagesë nuk është kryer nga ana e Bashkisë Vlorë prej shtatorit 2022 deri më shtator të 2023. Në total në periudhat 2021-gusht 2022 bashkia e Vlorës ka paguar në total 141,123,193 lekë të rinj.

Situata vazhdon të mbetet e njëjtë, qytetarët ende nuk kanë përfituar shërbimin e furnizimit me ujë në 15 fshatrat.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progresi dhe vlerësohet në masën 80% i njëjtë me raportin e vitit të tretë të monitorimit, krahasuar me 60%+ në raportin e periudhës së dytë të monitorimit dhe të prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshteje financiare nga AKUM dhe tenderim e lidhje kontrate dhe likuidim të punimeve nga bashkia)

***Orikum.** Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Projekti i furnizimit me ujë të pijshëm për fshatrat Dukat-Tragjas-Jonufër-Radhimë, financuar nga FSHZH dhe bashkëfinancim nga bashkia Vlorë, për paisjen me furnizim me ujë të pijshëm 24 orë, ka mbaruar. Nuk kemi të dhëna nëse bashkia Vlorë e ka marrë në dorëzim këtë vepër, por ende dhe sot zona e Orikumit vazhdon të vuajë mungesën e ujit, që në qytet vjen dy orë në ditë nga 45 minuta. Gjatë vitit 2022, me fonde të FSHZH në vlerën 6,9 milion euro është parashikuar ndërtimi/rikonstruksioni i Rrjetit të Ujësjellës Kanalizimeve Orikum, Impianti i Trajtimit të Ujërave të Zeza. Procedurat e tenderimit dhe lidhja e kontratës me subjektin Alkelik Group, kanë përfunduar në muajin maj të 2022, ndërsa periudha e zbatimit do të jetë 19 muaj e ndjekur nga një periudhë 12 mujore e njoftimit të defekteve. Ende ky investim nuk është bërë i prekshëm për banorët, ndërsa ata vazhdojnë të kërkojnë furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizimet e ujrave të ndotura.

Në lidhje me këtë prioritet, nuk ka progres është e njëjta situatë e raportuar si vitin e kaluar në masën 95%+ dhe është prioritet i adresuar drejt përfundimit.

***Qendër Vlorë.** Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Situata për banorët e fshatrave që presin prej vitesh të furnizohen me ujë është e njëjtë, pa ndryshime konkrete gjatë raportit të katërt të monitorimit. Vetëm zgjidhje provizore janë ofruar nga ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë, duke montuar një pompë të re në Shushicë dhe shtrimin e linjave të reja në Babicë. *Ndërsa gjatë vitit të katërt të monitorimit nuk ka të dhëna për ndryshimin e situatës.*

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres i arritur është 0, dhe mbetet i njëjtë me një vit më parë në masën 45% dhe është prioritet i adresuar (Studim fizibiliteti, mbeshteje financiare nga AKUM, tenderim e lidhje kontrate nga bashkia për pjesën e parë të projektit. Gjithsesi kohët e zbatimit të projektit janë të gjata dhe mbetet të shihet pas periudhës 2024 nëse do të ketë ndryshime të situatës)

Shushicë. *Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Rrjeti i ujësjesit është tepër i amortizuar për gjithë Nj. A Shushicë pavarësisht se ka burime shumë të mira ujore. Nga stacioni i pompave tek ish serrat (Shushicë) ndërmarrja e UK Sh.a Vlorë ka montuar një pompë centrifugale re dhe një pus shtesë në Shushicë, për të rritur sasinë e ujit, si dhe ka pastruar depon në Grabian për furnizimin me ujë sa më cilësor, nga raportimet në terren asgjë nuk ka ndryshuar nga raportet e mëparshme të monitorimit. Banorët vazhdojnë të furnizohen në çezmat kryesore të fshatrave ndërsa uji vazhdon të vijë me orar atje ku janë tubacionet e shtruara.

.Asnjë progres nuk është vërejtur në periudhën e monitorimit për Nj.A Shushicë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 20%+ dhe është prioritet i pa realizuar.

PRIORITET NR. 3: KANALIZIMET

- **Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësive vijuese:**

Rajonet e qytetit Vlorë. *Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Kryerja e investimeve në zonat periferike të Vlorës është një prioritet që ka gjetur zbatim në vitin e katërt të monitorimit. Projekti i mbështetur nga qeverisja qendrore përmes bashkisë Vlorë “Ndërtim KUZ, rrjeti tercial (Lidhjet familjare) për UK Vlorë”, ka sjellë ndryshime konkrete në disa zona periferike, ku janë shtruar linjat e kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza (zona e Fabrikës së Cimentos, Ujë i Ftohtë, etj). Ky objekt është parashikuar në buxhetin e shtetit për likuidim në vitet 2021-2024. Përmes tij pritet të sistemohet një pjesë e problemeve në lidhje me kanalizimet në qytetin e Vlorës.

Gjithashtu duam të theksojmë se prej kohësh, nga ana Bashkisë Vlorë është konfirmuar fakti që në Lungomare nuk derdheshin ujra të zeza ndërsa organizata të shoqërisë civile dhe qytetarët konfirmonin të kundërtën. Situata është denoncuar masivisht nga pushuesit gjatë verës së 2023 dhe janë identifikuar 10 kanale ku derdhen ujra të zeza. Përmendim edhe projektin tjetër të rëndësishëm përmirësimi i infrastruktures se ujërave të zeza në zonën bregdetare Vlorë, ku Bashkia Vlorë përmes ndërmarrjes së ujësjellësit ka kryer pagesa për periudhën mars-prill 2023, për firmën ITM-Studim Projektim i Rrjetit të Kanalizimeve nga Lungomare deri në hyrje të Radhimës Vlorë. Ndërsa identifikohen pagesa të kryera, përmes të dhënave të hapura, informacioni në territor për këto ndërhyrje është shumë i limituar.

Ndërsa zona të tjera në qytet vazhdojnë të vuajnë mungesën e investimeve të ujërave të ndotura. Mjaft zona periferike janë lënë jashtë vëmendjes dhe ndërhyrjet kryhen kryesisht nga qytetarët ose biznesit.

Duhet të theksojmë se investitori më i madh në këtë prioritet mbetet Qeverisja Qendrore me fonde të buxhetit të shtetit. Aktualisht po kryhen disa investime madhore që po vazhdojnë punimet edhe pse afatet e përfundimit të tyre janë midis 2023-2024 asnjë ndryshim nuk identifikohet nga qytetarët në territor. Të gjithë këto investime duhet të bëhen të prekshme për banorët dhe prej tre vitesh projektet janë vetëm duke disbursuar fonde, por ende nuk janë bërë funksionale për qytetarët.

Ndërmarrja e UK Vlorë, punën e saj e ka orientuar drejt pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit ekzistues të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, ndërsa ka sjellë rezultate konkrete në eliminimin e përmbajtjeve duke përmirësuar ndjeshëm situatën. Gjithsesi theksojmë se mjaft zona të tjera vazhdojnë të kenë probleme dhe duhet ndërhyrje e vazhdueshme në sektorin e kanalizimeve. Edhe mirëmbajtja dhe pastrimi i kanaleve në lagjet periferike (p.sh kanali i "Naunkës", në lagjen "24 Maj), duhet të kthehet në një proces periodik nga U.K Vlorë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 90%+ dhe është prioritet i realizuar. Mbetet të monitorohet në vazhdim rezultatet që do të sjellin ndërhyrjet e buxhetuara.

Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifiki në fshatrat Mifol dhe Akërnj.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Nuk ka informacione për ndryshim të situatës për vitin e fundit të raportimit, vetëm në KUZ Fitore dhe KUB Novoselë (ujëra të zeza dhe të bardha) janë hartuar projektet që janë pjesë e financimit të projektit të furnizimit me ujë të 15 fshatrave të Novoselës, që pritet të ndërhyet në vitet e ardhshme. Aktualisht deri në shtator të 2023, nuk ka ndryshim të situatës.

Në Orikum është hartuar projekti për KUZ dhe për vënien në punë të impiantit të ujërave të ndotura, financuar nga FSHZH dhe KFV. Ndërsa për Nj.A Qendrër dhe Shushicë nuk ka rrjet kanalizimesh dhe deri për periudhën e raportimit nuk ka një projekt përfundimtar për ndryshimin e situatës.

Në lidhje me këtë prioritet progresi është i njëjtë me atë të vitit të mëparshëm të raportimit 40%+ dhe është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 4: TRANSPORTI PUBLIK

- **Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.**

Këtij problemi i është dhënë zgjidhje që në vitin e parë të raportimit, duke i transportuar fëmijët në statusin e pasagjerit në linjë ndërqytetëse që në raportin e parë të monitorimit. Banorët rikonfirmojnë se kjo çështje është e zgjidhur dhe nuk përbën më problem.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 100% dhe është prioritet i realizuar.

PRIORITET NR. 5: TRANSPORTI PUBLIK

- **Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Sistemi i transportit urban në Vlorë realizohet përmes firmës Urban Trans Vlora, ndërsa transporti në rrjetin e linjave rrethqytetëse, kryhet përmes përdorimit të autovetura me 8+1 vende (jo taksi) ose shoqëri transporti, në linjat e mëposhtme: Vlorë – Orikum; Vlorë – Lllakatund; Vlore- Babicë dhe së fundmi edhe Vlorë – Novoselë. Oraret kryesisht varjojnë nga ora 7-14.00 për Nj.a-të, ndërsa në qytet deri në orën 20.00 e në verë deri në orën 22.00. Gjatë vitit 2022 janë miratuar orare më të zgjatura kryesisht drejt Orikumit dhe Novoselës.

Ndërsa kërkohet reformimi i transportit publik masiv veçanërisht për linjat urbane, ende nuk ka një terminal të caktuar për autobuzët, furgonat që kryejnë shërbimin e transportit urban brenda kësaj bashkie, ndërsa ka shumë pak dokumentacion të krijuar nga ana e bashkisë Vlore, bazuar në rregullore/plane veprimi të reja pas RAT. Nga prioritetet e qytetarëve shërbimi i transportit urban dhe rregullimi i tij, vazhdon të mbetet një nevojë që ka nevojë të adresohet më tepër nga Bashkia dhe KB.

Gjithësesi çështja e transportit publik për qytetarët u bë dhe pjesë e një peticioni drejtuar KB dhe Bashkisë Vlorë, por asnjë përgjigje nuk u adresua për zgjidhje. Gjatë fushatës elektorale transporti i bë kryefjala e të dy partive politike dhe kandidatëve të tyre. Pas zgjedhjeve situata vazhdon të mbetet njëlloj e pandryshuar dhe pa veprime konkrete.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres, situata vlerësohet me 65%, është prioritet i adresuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 6: PASTRIMI

- **Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Projekti në tërësinë e tij, sipas referimeve të Bashkisë me të gjithë komponentët e tij pritej të mbaronte në mars të 2023. Duke pritur që ky prioritet do të përfundonte, aktualisht ai është pezull, duke mos arritur të bëhet funksional. Prej korrikut të 2023, kjo vepër është bllokuar nga SPAK dhe është në administrim nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Për të analizuar situatën e zhvillimit të prioritetit nr.6, po japim një informacion të përgjithshëm që nga periudha e miratimit e deri më sot.

Më datë 15.12.2016, u nënshkrua marrëveshja për financimin e projektit të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në rajonin e Vlorës, ndërmjet Qeverisë Shqiptare të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Gjermane KfW. Sipas njoftimit të Ministrisë së Financave të datës 15.12.2016, Landfilli do të ndërtohet në Sherrishtë të Vlorës me një kapacitet prej rreth 350 mijë ton. Pjesë e investimit do të jetë ndërtimi i sistemit të mbledhjes së gazrave, impianti i trajtimit të ujërave të ndotura nga mbetjet, impianti i ndarjes së mbetjeve të riciklueshme me kapacitet 60,000 ton/vit, kapacitete kompostimi për mbetjet organike me kapacitet deri në 4,200 ton/vit¹¹.

Më datë 08.08.2019, sipas Agjencisë Gjermane për Zhvillim, u mbyll tenderi për ndërtimin e landfillit të Vlorës, me vlerë 9.8 milion euro. Tenderi do të financohet nga KfW Entdeckungsbank

Më datë 28.02.2020, me anë të vendimit nr. 02 të Keshillit Kombëtar të Territorit, u miratua leja për ndërtimin e landfillit rajonal për depozitimin e mbetjeve të ngurta në rajonin e Vlorës, Faza 1, me vendndodhje në Bashkinë Vlorë.

Programit Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta në Qarkun Vlorë, që vijon nga 2020, ku buxheti i shtetit ka planifikuar gjithësej 695.4 milion lekë, nga të cilat 200 milion janë grant dhe 450 milion janë kredi.

IV. Më datë 12.06.2020, u shpall fituesi i tenderit që është bashkimi i kompanive JV Bulfaro dhe Integrated Technology Services. Vlera e kontratës ishte 9.801.624,04 euro. Kohëzgjatja e kontratës ishte 1.5 vite.

Ndërtimi i qendrës së menaxhimit të mbetjeve urbane (përfshirë venddepozitimin) në afërsi të fshatit Sherishtë (komponenti i parë është aktualisht në zbatim, është përfunduar në masën 93% e punimeve dhe nuk ka ndryshim nga raporti i tretë i monitorimit), me komponentët komplementarë të venddepozitimit sipas kuadrit ligjor dhe standarteve të BE-së. Komponenti i parë përfshiu “Projektin e ndërtimit të qendrës së menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë landfillin, impiantin e ndarjes dhe selektimit të mbetjeve, impiantin e trajtimit të ujrave të

¹¹ <https://financa.gov.al/financimi-i-projektit-te-menaxhimit-te-mbetjeve-te-ngurta-ne-vlore-vemendje-e-posacme-per-mjedisin-dhe-turizmin-2/>

ndotura që gjenerohen nga mbetjet, godinën administrative të ndërmarjes që do menaxhojë qendrën e mbetjeve, magazinën, me vendndodhje në Sherishtë” që sipas bashkisë është investimi i parë infrastrukturor në fushën e trajtimit të mbetjeve urbane në Vlorë. Ndërsa pritej të përfundontë fillimisht në muajin shtator 2022, sipas komunikimeve të zyrtarëve të Bashkisë, çelja e tij u spostua për muajin mars 2023. Ndërmarrja që administron vendepozitimin për këtë qëllim në buxhetin e aprovuar në janar 2023, shtoi dhe numrin e punonjësve në total prej 39 persona, të cilët aktualisht merren me komponentët e tjerë të projektit, ndërsa vendepozitimi është i bllokuar nga SPAK dhe GJKKO.

Më datë 28.03.2022, sipas vendimit Nr.134, lëshuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u vendos pranimi i kërkeses së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe caktimi i masës së sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për personin juridik “Integrated Technology Services” shpk me NUIS (NIPT) - L02302032C, së bashku me pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi të tij

Në muajin muajin gusht 2023, urdhërohet me Vendim Nr.95, datë 28.07.2023, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, masa e sigurimit pasuror “sekuestro preventive” për personin juridik “Integrated Technology Waste Treatment”. Shoqëria i kalon në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (Institucion Shtetëror), dhe emërohet administrator z.Arjan Baci

Prej vitit të fundit të monitorimit vepra është e pezulluar ndërsa situata vazhdon akoma më problematike në vendepozitimin ekzistues. Ai është i rrethuar nga shtëpitë e banimit. Fusha e mbetjeve të Vlorës ka një sipërfaqe prej 12.6 Ha, ndërsa kanali i ujërave të zeza është vetëm 5 metra larg. Ministria e Mjedisit që në vitin 2015 ka propozuar që ky vendepozitim të mbyllet. Por deri në momentin e përfundimit të punimeve të landfillit të Sherishtës, mbeturinat e Bashkisë së Vlorës depozitohen të gjitha këtu pa u diferencuar.

Zona ku ndodhet landfilli që prej vitit 2004 me Vendim të Këshillit të Ministrave është shpallur zonë e mbrojtur, pavarësisht kësaj makinat e mbetjeve kurrë nuk kanë ndaluar së hedhuri mbeturina. Zjarret e vazhdueshme dhe tymi që shpërndahet në qytet vjen nga depozitimi i mbetjeve të shumta gjatë verës në fushën aktuale të grumbullimit, për shkak të grumbullimit të gazit metan dhe vatrave të zjarrit, nën temperaturat e larta.

Gjatë periudhës së monitorimit është miratuar Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Bashkia Vlorë për periudhën 2023-2028¹², në datën 30.03.2023 nga ana e KB Vlorë. Prej një viti plani i përgatitur nuk arriti të aprovohej më parë. Plani është një dokument i rëndësishëm që në një pa situata anaormale do të duhej të rregullonte gjithë menaxhimin e integruar të mbetjeve për një periudhë 5 vjeçare. Plani njihet pak nga administrita vendore dhe institucione të tjera. Gjithësesi kur situata të normalizohet, vendepozitimi i Sherishtës të bëhet funksional, djegia e mbetjeve të mos ndotin ambientin dhe të mos helmojnë banorët dhe turistët në Vlorë atëherë besojmë se ai do të jetë një dokument që njihet dhe aplikohet në punën e përditshme të Bashkisë Vlorë.

¹² https://vlora.gov.al/projekt-vendim-per-miratimin-e-planit-vendor-te-menaxhimit-te-integruar-te-mbetjeve-bashkia-vlore/?fbclid=IwAR14I717k_JQKIDGeFiGWk1jAWJvGIQwK00fafCW1d6H8z5clerOQa31BE

Gjithësesi PVMIM shërbeu për transferimin e shërbimit nga firmat private drejt bashkisë dhe më saktësisht drejt administrimit të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe ndarjen e përgjegjësi midis dy drejtorive asaj të MIM dhe NSHP.

Edhe pse ishte parashikuar që ky prioritet, të paktën për lotin e parë, atë të ndërtimit të landfillit sanitar të përfundonte në fillim të vitit 2022 dhe ndërmarrja e MIM raporton se janë kryer pothuajse të gjitha punimet, vepra ende nuk është bërë funksionale për banorët e Vlorës.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres dhe në vitin e katërt të monitorimit raportohet e njëjta përqindje si e vitit të tretë në 85%+, dhe është prioritet i adresuar drejt realizimit faktik.

PRIORITET NR. 7: PASTRIMI

- **Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:**

Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstruksion (p.sh rruga “Shyqyri Alimerko”). Në pjesën e “Lungo Mares” i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Shtimi i koshave dhe paisjeve teknologjike ndikoi edhe në performancën për shërbimin e pastrimit. Deri në mars të 2023 shërbimi i menaxhimit të mbetjeve ofrohej nga tre kompani private që ofrojnë në zona 1: Qyteti Vlorë me kontratë të vlefshme deri me datë 03.07.2023, Zona 2, ajo Veriore, me kontratë të vlefshme deri me datë 30.04.2023 dhe Zona 3, Orikum me kontratë të vlefshme deri me datë 25/03/2023.

Me marrjen në administrim nga NSHP të mjeteve dhe pajisjeve të reja për menaxhimin e mbetjeve dhe me përfundimin e afateve të kontratave me operatorët privatë, bashkia ofroi një shërbim të unifikuar në gjithë territorin e saj. Bashkia Vlorë me VKB nr.27 datë 31.03.2023 miratoi kalimin e ofrimit të shërbimit të pastrimit nga operatorët privatë, të entiteti publik në të gjitha zonat e kontratës ku u përfshinë qyteti i Vlorës dhe Nj.A-ve. Perceptimi publik për përballimin e situatës në periudhën e sezonit turistik ishte kryesisht pozitiv, ndërsa mediat lokale dhe rrjetet sociale krijuan presionin e nevojshëm për të përmirësuar punën në qytet. Përsa i përket djegies së mbeturinavë sqaruam situatën në vendepozitim, në prioritetin më sipër.

Gjithashtu edhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) ka ofruar shërbimin e pastrimit të kësaj njësie në zonën bregdetare, për periudhën 15 qershor – 15 shtator 2023.

Në lidhje me këtë prioritet, kërkesat fillestare të qytetarëve të Vlorës, të pasqyruar në Kontratën Sociale, kanë marrë zgjidhje, në pjesën më të madhe të tyre. Në raportet e mëparshme Qendra

Rinore e Vlorës ka bërë një analizë të thelluar si funksionon shërbimi i pastrimit të mbeturinave në qytet dhe Nj.A.

Nga monitorimi i vitit të fundit vlerësojmë se progresi është i njëjtë me vitin e mëparshëm në 90%+.

Shërbimi cilësor dhe shtimi i koshave sidomos gjatë sezonit turistik: Gjatë periudhës së monitorimit, në bashkinë Vlorë dhe sidomos në qytet janë instaluar kontenierët e rinj, si pjesë e projektit të menaxhimit të mbetjeve në Qarkun e Vlorës, mbështetur nga KFW-ja,

Në lidhje me këtë prioritet progresi i njëjtë me vitin e mëparshëm të raportimit në masën 90%+ dhe është prioritet i realizuar.

Novoselë. *Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Njësia Administrative Novoselë ka 96 pika të grumbullimit të mbetjeve ku janë të instaluar së fundmi në total 43 kontenierë dhe 53 pika të tjera në hapësirën e 12 fshatrave, që mbulon një sipërfaqje prej 254,000 m². Ndërkohë që shërbimi aktualisht ofrohet nga Bashkia Vlorë pas përfundimit të kontratës së firmës private të kontraktuar. Ka të dhëna të paqarta që nuk tregojnë nëse Nj.A Novoselë ka përfituar 139 kontenierë nga viti i mëparshëm apo 43 kontenierë që ka aktualisht në periudhën e monitorimit. Gjithashtu shërbimi i pastrimit vlerësohet pozitivisht nga vetë administrata e kësaj njësie, ndërsa banorët shprehën se nuk ka ndonjë ndryshim madhor me ndryshimin e administrimit. Nevojitet një analizë e thelluar për të verifikuar nëse shërbimi i pastrimit është cilësor përmes tërheqjes së mbeturinave 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Në lidhje me këtë prioritet nuk evidentohet progres i arritur gjatë vitit të katërt të monitorimit. Ndaj vlerësimi është i njëjtë me vitin e tretë që ishte 70+%, krahasuar me 30% që kanë në periudhën e dytë të monitorimit dhe është prioritet i realizuar.

Orikum. *Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dezinfektimi i koshave ekzistues. Eliminimi i plotë i djegies së mbeturinave.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Shërbimi i pastrimit të Nj.A Orikum realizohej nga firma “Baitel” sh.p.k. që ka fituar tenderin 3-vjeçar nga Bashkia e Vlorës. Prej gushtit e deri në shtator ky shërbim është kryer nga NSHP, që ka mbajtur peshën e administrimit gjatë sezonit turistik. Gjithashtu edhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) ka ofruar shërbimin e pastrimit të kësaj njësie në zonën bregdetare, për periudhën 15 qershor – 15 shtator 2023. Në këtë Nj.A grumbullimi i mbeturinave bëhet në 215 konteniere ose pika grumbullimi Edhe Nj.A Orikum ka përfituar nga shpërndarja e kontenierëve që janë transferuar nga Bashkia e Vlorës, por nuk kemi të dhëna nëse ato janë vendosur në

vendet e caktuara apo janë të magazinuara. Gjatë verës ka patur shqetësime që janë trasmetuar në mediat lokale mbi cilësinë e shërbimit në këtë njësi, ndërsa dhe vendgrumbullimi ekzistues është në gjëndje të mjerueshme dhe ka patur raste të rënies së zjarreve.

Gjithsesi qytetarët e njësisë administrative Orikum vazhdojnë të kenë shqetësime në lidhje cilësinë e pastrimit në qytet dhe fshatrat që ndodhen përgjatë zonës turistike, që kanë nevojë për vëmendje të shtuar gjatë sezonit të verës. Gjithashtu ka nevojë të dezinfektohen të gjithë kontenierët e mbeturinave, ndërkohë që dezinfektohen vetëm disa prej tyre në qendër të qytetit.

Në lidhje me këtë prioritet nuk ka progres të arritur. Vlerësimi është 30% + i njëjtë me vitin e tretë të monitorimit nga 20%+ që ishte në vitin e dytë të monitorimit dhe është prioritet i pa realizuar.

Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Bashkia Vlorë ka arritur të përmbushë një prej kërkesave të banorëve, shërbimi në këtë Njësi Administrative kryhet me operator privat, përmes kontratës me shoqërinë “REJ” sh.p.k. me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësisë Administrative Qendër”, që ka përfunduar këtë vit. Pas përfundimit të kontratës shërbimin realizohet nga Bashkia Vlorë. Në këtë njësi administrative janë të shpërndara 30 pika grumbullimi/ kontenierë. Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve nga familjet dhe bizneset përgjatë bregdetit Nartë–Zvërnec kryhet çdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj. NSHP e bashkisë ka ndërhyrë përmes pastrimit të vendepozitimeve të mbeturinave duke u fokusuar të pikat në vende turistike apo të rrugëve lidhëse të kësaj njësie. Gjithashtu janë transferuar edhe disa kontenierë nga bashkia Vlorë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është 50% i njëjtë me periudhën e mëparshme dhe është prioritet në progres për tu realizuar.

Shushicë. Urgjente shtimi i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Me mbarimin e kontratës së firmës së pastrimit edhe në këtë njësi është pastruar nga NSHP e bashkisë ku vendepozitime mbeturinash që gjendeshin prej vitesh në rrugët lidhëse të kësaj njësie, si dhe janë shpërndarë kosha nga bashkia.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur vlerësohet i njëjtë 50%, me vitin e tretë të monitorimit, krahasuar me 40% që ishte në vitin e dytë të monitorimit dhe është prioritet në progres për tu realizuar.

PRIORITET NR. 8: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Bashkia Vlorë, vazhdon edhe në këtë vit të katërt të monitorimit të lehtësojë informacionin dhe shpërndarjen e tij për programet mbështetëse që qeverisja qendrore ka aktivizuar përmes ministrisë së bujqësisë dhe Agropikës. Në qytet përmes nën/kryetares së bashkisë dhe Nj.A nga administratorët dhe agronomët e tyre janë shpërndarë informacione dhe dokumente për të aplikuar në programe të ndryshme. Bashkia përmes mediave sociale ka promovuar ose ka lidhur fermerë ose biznesmenë të ndryshëm që punojnë në fushën e bujqësisë, për të promovuar produktet e në panaire brenda dhe jashtë vendit. Është bërë një punë e mirë që ka koordinuar fermerët që kanë patur një numër të rritur në aplikimet dhe subvencionet e përfituara nga Ministria e Bujqësisë. Sesione informuese janë zhvilluar me fermerë dhe informacione të nevojshme janë shpërndarë në territor, kryesisht për kulturën e ullirit, vreshatrisë dhe produkteve të tjera lokale. Gjithashtu edhe në nivel ndërkombëtar janë promovuar dhe fermerët lokalë që kanë zhvilluar shkëmbime aktivitetesh, vizita studimore ose janë partnerë për projekte ndërkombëtare.

Gjithashtu bashkia e Vlorës ka zhvillua disa aktivitete me anëtarët të Grupit Vendor të Veprimit për zonën Novoselë dhe Qendër (VJONA LAG) dhe është duke punuar me anëtarët e tij e partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për fuqizimin e tij.

Duhet theksuar se në të dhënat makroekonomike të bashkisë Vlorë, sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, programet e saj i fokuson në : 1. Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve; 2. Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit; 3. Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave. Bazuar mbi keto programe investimet e saj për vitin 2022 janë në riskonstruksionin e hidrovorit të Akërnisë si dhe pastrimin e kanaleve ujitëse dhe kulluese.

Ndërsa në lidhje me përfundimin e procesit të menaxhimit të tokave, vazhdohet te ecet me ritme të ulta, edhe pse nevojat vazhdojnë të jenë të larta nga qytetarët. Përshpejtimi i këtij procesi ndikon edhe në programin e mbështetjes së fermerëve, të cilët mund të aplikojnë për mbështetje nga fondet e AZHBR-së për mbështetje financiare.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur për raportin e tretë të monitorimit është 90%+ nga 80% ne vitin e tretë të monitorimit krahasuar me 70% në raportin e dytë të monitorimit dhe është prioritet i adresuar.

PRIORITET NR. 9: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Vlerësojmë se Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka realizuar në masën 98% njoftim- vleresimet mbi detyrimet tatimore në formë shkresore dhe zyrtarisht drejt subjekteve ekonomike. Për të komunikuar në kohe reale njoftimi dërgohet edhe me email. Korespondenca me QKB bëhet në kohë reale duke shmangur penalitetet e bizneseve, që mund të vijnë nga pagesa e detyrimeve me vonesë.

Fale përmirësimit të punës dhe komunikimit me biznesin dhe qytetarët në dhjetor të 2022 janë arketuar 98% e taksave dhe tarifave vendore të planikuara. Gjithashtu në bazë të delegimit të kompetencave struktura përkatëse është afruar më afër biznesit/qytetarëve duke ofruar shërbime në kohe reale

Komunikime të vazhdueshme në mediat sociale, lokale apo dhe në takimet ballë për ballë janë realizuar për të informuar qytetarët dhe bizneset lokale. Vlerësojmë përpjekjet e vazhdueshme të kësaj drejtorie që ndër të tjera edhe me stafin e Qendrës Rinore ka mbajtur komunikime të vazhdueshme për mënyrat si mund të lehtësohet komunikimi me qytetarët.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur në vitin e katërt të monitorimit është në masën 90%, krahasuar me vitin e tretë të monitorimit që ishte 70%+ dhe është prioritet i realizuar

PRIORITET NR. 10: ZHVILLIM EKONOMIK

- **Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Gjatë monitorimit të periudhës, raportojmë se bashkia Vlorë nuk ndërmorri ndonjë program të veçantë që mbështeti grupet e të rinjve apo ato të grave.

Mbetet për tu monitoruar në vazhdimësi mbi shërbime të reja konkurruese që bashkia mund të ofrojë në këtë sektor duke e matur edhe me numrin e përfituesve që përfitojnë nga ky shërbim.

Në lidhje me këtë prioritet situata paraqitet e njëjtë dhe vlerësohet me të njëjtën rezultat si vitin e kaluar 60%+ dhe është prioritet i realizuar pjesërisht.

PRIORITET NR. 11: DEMOKRACIA VENDORE

Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- *mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;*
- *përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;*
- *mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;*

- *raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.*

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Bashkia Vlorë vlerësohet pozitivisht për realizimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje. Ajo ka përmirësuar implementimin e procesit të Buxhetimit me Pjesëmarrje, përmes realizimit të dëgjësave të hapura të dokumentuara me rregjistrime dhe publikime në mediat sociale dhe lokale, ndërsa vazhdon të konsolidojë efektivitetin e këtij mekanizmi. Bashkia ka realizuar 9 dëgjësja në cdo njësi administrative dhe rajon të qytetit, ndërsa është vënë re pjesëmarrje e ulët qytetare. Bashkia e asistuar edhe nga qendra Rinore e Vlorës, përdor edhe metoda alternative të mbledhjes së perceptimeve dhe prioriteteve online, përmes anketimit të qytetarëve. Për vitin 2022 rreth 642 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit të ri vendor.

Mbetet ende për të bërë, lidhur me detyrimet ligjore për zbatimin e ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik, gjithsesi vlerësohet si progres pozitiv realizimi i këtij prioriteti.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është në të njëjtën vlerë 90%+ dhe është prioritet i realizuar

PRIORITET NR.12: DEMOKRACIA VENDORE

- **Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.**

Gjetjet nga monitorimi dhe progresi në periudhën shtator 2022 – shtator 2023:

Ngritja e Këshillit Vendor të Rinisë u bë, më 3 gusht 2022. Pas krijimit të këtij këshilli e deri në periudhën e përgatitjes së këtij raporti asnjëherë nuk është mbledhur zyrtarisht ky organizëm. Vlerësojmë vetëm anëtarët e Këshillit Bashkiak që thirrën të rinj përfaqësues të këtij këshilli dhe degjuan komentet dhe mendimet e tyre. Përfaqësuesit e bashkisë i kanë mbajtur të angazhuar të rinjtë përmes shpërndarjes së informacioneve për trajnim ose përfaqësim që janë zhvilluar në nivel kombëtar, por rekomandohet që të rinjtë të përfshihen realisht në jetën publike dhe jo sa për fasadë.

Në lidhje me këtë prioritet progresi i arritur është i njëjtë me raportin e vitit të tretë të monitorimit në masën 70%+ dhe është prioritet i pa realizuar.

Referenca

Faqja zyrtare e bashkisë Vlorë <http://vlora.gov.al/>

Faqja zyrtare e Këshillit të Bashkisë <http://vlora.gov.al/category/degjesat-publike/>
<https://www.facebook.com/p/Keshilli-Bashkiak-Vlore-100066360228798/>

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2023 <https://vlora.gov.al/buxheti/>
<https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2023/05/Projektvendim-Buxheti-Faktik-2022.pdf>

Kontrata Sociale Vlorë <https://popnetwork.al/wp-content/uploads/2020/07/Vlora-Prioritetet-A3-Kontrata.pdf>

Ecuria e prioritetit 6- në media: <https://www.reporter.al/2023/06/14/ngec-projekti-i-landfillit-te-vlores-ndersa-plehurat-mbeten-rrugeve/>

<https://www.youtube.com/watch?v=q5ixndCf604>

Prioriteti 12: Takim me anetare te KB dhe anëtarë të Këshillit Venor të Rinisë, si pjesë e monitorimit të Kontratës Sociale: <https://l8.nu/qWu6>

ANEKS

Tabela krahasuese e monitorimit të progresit të prioriteteve të Kontratës Sociale.

PRIORITETI	Periudha Gusht 2019- Gusht 2020	Periudha Shtator 2020- Shtator 2021	Periudha Shtator 2021- Shtator 2022	Periudha Shtator 2022- Shtator 2023	Realizimi
PRIORITET 1: Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit..	50%	70%	78%	80%	Progres i adresuar pjesërisht
<i>Për rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit: Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave, rruga nga Porti drejt plazhit të vjeter, rruga “Jani Kosta”, rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Vendosje e sinjalistikës horizontale dhe/ose vertikale në zonat ku aktualisht mungon.</i>	50%	70%	80%	90%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<i>Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë</i>	100%	100 %	100%	100%	Prioritet i realizuar plotësisht
<i>Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Rradhimës dhe të Thilpetit.</i>	10%	30%	30%	30%	Prioritet i pa realizuar

Qendër Vlorë. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rruget lidhëse të Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.	40%	70%	90%	90%	Prioritet i realizuar
Shushicë. Kërkohet rikonstrukcion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.	50%	80%	90%	90%	Prioritet i realizuar
PRIORITET 2: Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për	36%	56%	64%	64%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit të Vlorës. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm	50%	70%	80%	80%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijojnë probleme me furnizimin vecanërisht gjatë verës.	20%	60%	80%	80%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat.	80%	90%	95%	95%	Prioritet i realizuar
Qendër. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.	10%	40%	45%	45%	Prioritet i pa realizuar
Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.	20%	20%	20%	20%	Prioritet i pa realizuar
PRIORITET 3: Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njëjësive vijuese:	60%	65%	65%	65%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.	80%	90%	90%	90%	Prioritet i realizuar
Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Ndërhyrje në	40%	40%	40%	40%	Prioritet i adresuar pjesërisht

sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akërni.

- PRIORITET 4:** Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.
- PRIORITET 5:** Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00
- PRIORITET 6:** Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë
- PRIORITET 7:** Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:
- Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.**
- Novoselë.** Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.
- Orikum.** Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues.

PRIORITET 4: Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.	100%	100%	100%	100%	Prioritet i realizuar
PRIORITET 5: Shtim i shërbimit të transportit urban dhe në lagjet periferike të qytetit. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00	50%	50 %	65%	65%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 6: Të vihet në funksion impianti i venddepozitimit të mbeturinave në Sherishtë	50%	80%	85%	85%	Prioritet i adresuar pjesërisht
PRIORITET 7: Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:	20%	42%	58%	58%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbim cilësor dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.	80%	80%	90%	90%	Prioritet i adresuar pjesërisht
Novoselë. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.	0%	30%	70%	70%	Prioritet i pa realizuar
Orikum. Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues.	10%	20%	30%	30%	Prioritet i pa realizuar

Eliminimi i plotë i diegjes së plehrave

Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike te vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.

Shushicë. Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

PRIORITET 8: Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave.

PRIORITET 9: Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre.

PRIORITET 10: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gratë.

PRIORITET 11: Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxheti me Pjesmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

10%	40%	50%	50%	Prioritet i pa realizuar
10%	40%	50%	50%	Prioritet i pa realizuar
50%	70%	80%	90%	Prioritet i adresuar pjesërisht
10%	40%	70%	90%	Prioritet i realizuar
10%	60%	60%	60%	Prioritet i pa realizuar
80%	90%	90%	90%	

<p>-mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit por dhe mbledhje të nevojave të qytetarëve;</p> <p>- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese;</p> <p>-mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;</p> <p>-raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.</p>					Prioritet i realizuar
<p>PRIORITET NR.12: Të krijohet Këshilli Rinor Vendor për të rritur pjesmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.</p>	50%	60%	70%	70%	Prioritet i adresuar pjesërisht
<p>TOTALI</p>	47.17%	65.25%	73.75%	76.41%	Prioritete të adresuara pjesërisht

ⁱ <https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/Projekt-Vendim-Miratimi-i-punes-se-K.B-Vlore-Janar-2023.pdf>

ⁱⁱ https://vlora.gov.al/projekt-vendim-per-miratimin-e-planit-vendor-te-menaxhimit-te-integruar-te-mbetjeve-bashkia-vlore/?fbclid=IwAR14I717k_JQKIDGeFiGWk1jAWJvGIQwK00fafCW1d6H8z5clerOQa31BE

ⁱⁱⁱ <https://vlora.gov.al/wp-content/uploads/2023/03/PVMIM-Vlore-30.03.2023.pdf>